


Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ) të Kosovës Eksport/Import Janar-Qershor 2026

Sipas të dhënave mujore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për periudhën Janar-Qershor 2026, deficitit tregtar për Kosovë ka shënuar një rritje prej 6.1% në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, duke arritur në -3,092.5 milion euro nga -2,915.3 milion euro në vitin 2025. Mbulueshmëria e importit nga eksporti arrinë në 14.4%.

Figura 1. Bilanci tregtar i mallrave Kosovë, Janar-Qershor sipas viteve, në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela 1. Bilanci tregtar i mallrave për Janar-Qershor, sipas viteve në milion Euro, mbulueshmëria importi me eksport dhe rritje (v-m-v)

Viti	I-VI/2022	I-VI/2023	I-VI/2024	I-VI/2025	I-VI/2026
Eksport	492.5	433.9	443.4	437.3	521.2
Import	2,646.3	2,686.7	2,883.8	3,352.5	3,613.7
Bilanci tregtar	(2,153.7)	(2,252.8)	(2,440.4)	(2,915.3)	(3,092.5)
% e mbulimit	18.6%	16.2%	15.4%	13.0%	14.4%
Exp. % v-m-v	42.9%	-11.9%	2.2%	-1.4%	19.2%
Imp. % v-m-v	28.2%	1.5%	7.3%	16.3%	7.8%
Bila. Treg. % v-m-v	25.3%	4.6%	8.3%	19.5%	6.1%


Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Analizuar në periudhën e fundit pesëvjeçare bilanci tregtare i mallrave në Kosovë, karakterizohet me rritje të vazhdueshme. Deficitit tregtar është zgjeruar çdo vit, duke u rrit nga -2,153.7 milionë euro sa ishte në TM1,2/2022 në -3,092.5 milionë euro në periudhën e njëjtë 2026.

Importet kanë shënuar rritje të pandërprerë, ato u rritën nga 2,646.3 milionë euro në vitin 2022 në 3,613.7 milionë euro periudhën e njëjtë 2026. Ndërsa Eksportet e Kosovës drejt vendeve tjera patën luhatje deri në vitin 2025, pavarësisht rritjes së dukshme të eksporteve në këtë periudhë të vitit 2026 prej 19.2%, mbetet i pamjaftueshëm për të balancuar rritjen nominale të importeve.

Si rezultat i këtij trendi të pabarabartë tregtar, bilanci tregtar i mallarve ka mbetur vazhdimisht negativ për Kosovën. Në terma vjetorë për periudhën janar-qershor 2022-2026, deficit ka shënuar një rritje mesatare prej rreth 12.7% (v-m-v), duke reflektuar një varësi të lartë nga mallrat e importuara dhe një kapacitet të kufizuar të prodhimit vendor për të përmbushur kërkesën e brendshme apo për të konkurruar në tregjet ndërkombëtare.

Figura 2. Eksport/Importi Kosovë, TM1,2 sipas viteve në milionë Euro



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Eksporti i mallrave, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, ka një trend në rritje duke regjistruar vlerat prej 521.2 milionë euro, apo rreth 19.2% më shumë se periudha e njëjtë e vitit 2025. Ndërsa krahasuar në sasi (neto kg), për periudhën raportuese Eksporti i mallrave shënoi rritje për rreth 86.4 mijë tonë, apo rreth 23.0% më shumë sasi(kg) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, që mund të jetë ndikuar nga lloji i mallrave të eksportuara.

Partnerët kryesorë të Eksporti i mallrave në 2026 janë: Maqedonia e Veriut me 16.9%, Shqipëria me 14.6%, Zvicra me 10.7%, Gjermania me 9.9%, Serbia me 6.9% Mali i Zi me 5.7% etj. si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm. Vendet e rajonit si Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria vazhdojnë të mbeten destinacionet kryesore për prodhimet kosovare, duke konfirmuar rëndësinë e tregut rajonal.


Importi i mallrave, Janar-Qershor 2026 arrinë në 3,613.7 milionë euro apo 7.8% më shumë se periudha e njëjtë e vitit paraprak. Analizuar në sasi (neto kg), importi i rregullt i mallrave shënoi rritje për rreth 171.7 mijë tonë, apo rreth 5.0% më shumë sasi(kg) krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Partnerët kryesorë të importi i mallrave për 2026 janë: Gjermania me 13.6%, Kina me 13.5% dhe Turqia me 11.9%, pasuar nga Italia me 6.3%, Maqedonia e V. me 4.8%, Greqia me 4.5%, Shqipëria me 4.1%, Polonia me 4.0%, Serbia me 3.1% etj. si pjesëmarrje në vlerën e përgjithshme të importeve.

Struktura e Eksportit/Importit Janar Qershor 2025 - 2026 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve

Sipas të dhënave nga Open_DATA Doganat e Kosovës(DK) për Tremujori 1 dhe 2/2026 grupet kryesor të Eksportit e përbëjnë: 26.0% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 11.6% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 11.5% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 8.8% Artikuj të ndryshëm të prodhura(mobileri, krevat, dyshek, jastëk etj); 8.5% Produkte minerale; 7.3% Tekstil dhe artikuj tekstili; 6.1% Makineri, paisje mekanike dhe elektrike etj. si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm të Kosovës.

Figura 3. Struktura e Eksportit Janar Qershor 2025-2026 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rritja e eksporteve për 19.2% apo rreth 83.9 milionë euro më shumë mallra të eksportuara në gjashtëmuajin 2026 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja te sektorët si, Metalet bazë dhe artikujt prej tyre (nga 23.7% në 26.0%), Produkte minerale (nga 5.9% në 8.5%) dhe një rritje e lehtë te Tekstil dhe artikuj tekstili (nga 6.8% në 7.3%) etj. si pjesëmarrje në eksportin e përgjithshëm.

Te Importet për Tremujori 1 dhe 2/2026, kemi këtë renditje të sektorëve-grupe kapitujve kryesor si në vijim: 15.1% Produkte minerale; 13.1% Makineri, paisje mekanike dhe elektrike; 11.6% Ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11.4% Mjetet e transportit; 9.7% Metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 8.0% Produkte të industrisë kimike; 5.2% Tekstil dhe artikuj tekstili; 5.2% Plastikë, gomë dhe artikuj prej tyre; 5.0% Kafshë të gjalla, produkte me origjinë kafshe etj. si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm të Kosovës.

Figura 4. Struktura e Importit Janar Qershor 2025-2026 sipas Sektorëve/grupeve të kapitujve në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Open_DATA Doganat e Kosovës(DK)

Rritja e importeve për 7.8% apo rreth 261.2 milionë euro më shumë mallra te importuara në vitin 2026 krahasuar me vitin paraprak, është ndikuar kryesisht nga rritja e sektorëve me ndikim te madh si Produkte minerale(nga 14.8% në 15.1%), Makineri, paisje mekanike dhe elektrike (nga 12.1% në 13.1%) dhe Metalet bazë dhe artikujt prej tyre (nga 9.3% në 9.7%) etj. si pjesëmarrje në importin e përgjithshëm.